

FTESË PËR NEGOCIM

Autoriteti kontraktor : Ministria e Mbrojtjes.

Objekti : “Prodhimi i spoteve promovuese me rastin e 10 vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO”.

Fondi limit : **2,860,000** (dy milionë e tetëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë pa T.V.SH., vënë në dispozicion nga buxheti i shtetit, për vitin 2019.

Afati i kryerjes së shërbimit : 10 (dhjetë) ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Data e zhvillimit : 28.03.2019, ora 12:00

Vendi : Ministria e Mbrojtjes

Afati kohor për dorëzimin e ofertave : 28.03.2019, ora 12:00

A. Shërbimet e kërkuara dhe Specifikimet Teknike të tyre:

1) PRODHIM VIDEO PROMOVUESE PER SOCIAL MEDIA ME TEMATIKEN 10 VJET NATO NE SHQIPERI

Gjatësia e videos duhet të jetë jo më e vogël se 1 (një) minutë.

Operatori merr përsipër të krijojë konceptin, skenarin ose storyboarding e videos.

Cilesia e videove të xhiruara duhet të jetë e standardit High Definition.

Audio dhe Kolona zanore duhet të jetë cilësore me parametrat 48khz dhe 24-bit depth.

Efektet audio dhe efektet muzikore që do të shoqërojnë videon trajnuese të zoterojnë të gjitha te drejtat e përdorimit pa limit në hapësirë gjeografike apo kohore.

Videot do të shoqërohen me voiceover.

Videot do të shoqërohen me titra.

Videot duhet të shoqërohen me sloganin kryesor, logon zyrtare të 10 vjetorit të anëtarësimit në NATO.

Operatori siguron të gjithë infrastrukturën e nevojshme, lëvizjet, stafin dhe lejet e xhirimit në lokacione të ndryshme ne vend.

Produkti final duhet të jetë format video HD 1080.

Produkti final duhet të dorëzohet në material dixhital CD ose USB

Afati i prodhimit 10 ditë pune nga nënshkrimi i kontratës.

2) PRODHIM TV SPOT PËR PROMOVIMIN E EVENTIT 10 VJET NATO

Gjatësia kohore e spotit është jo më shumë se 60 sekonda.

Operatori merr përsipër të krijojë konceptin, skenarin dhe storyboarding e spotit. Spoti duhet të përmbajë xhirime shumë cilësore HD.

Përmbajtja do të jetë:

Momente të trupave të FA gjatë trajnimeve apo stërvitjeve ushtarake.

Audio dhe kolona zanore e spoteve duhet të jetë cilësore me parametra 48 khz dhe 24-bit depth.

Efektet audio dhe efektet muzikore që do të shoqërojnë spotet të zoterojnë të gjitha të drejtat e përdorimit pa limit në hapësirë gjeografike apo kohore.

Spoti do të shoqërohet me voiceover.

Spoti do të shoqërohet me titra.

Spoti duhet të shoqërohet me slloganin kryesor dhe logon 10 Vjet në Nato.

Spoti duhet të publikohet në ëëbsitin zyrtar të MM.

Operatori siguron të gjithë infrastrukturën e nevojshme, lëvizjet, stafin dhe lejet e xhirimit në vendndodhjet e përcaktuara.

Produkti final duhet të jetë format video HD 1080.

Produkti final duhet të dorëzohet në material dixhital usb.

Afati i prodhimit 15 ditë pune nga lidhja e kontratës.

3) PRODHIM VIDEO ANIMACIONI I LOGOS 10 VJET NATO NE SHOIPERI

Operatori duhet të realizojë një animacion video e cila do të shërbejë për promovimin e logos në rrjete sociale si dhe në led ëall.

Ky animacion do të aplikohet në 3 formate:

- Format i me logon Shqip

- Format i me Logon Anglisht

- Format i për kover facebook

Gjithashtu ky animacion do të krijohet me sfondin në ngjyrën e logos (blu e thellë) si dhe me sfond të çelur (e bardhe ose gri e hapur)

4) MEDIABUYING - PLANI MEDIATIK

Plani mediatik duhet të kryhet mbi kërkesën e transmetimit të një spoti me kohëzgjatje 30 sekonda.

Plani i komunikimit për transmetimin e spotit televizive do të jetë i shtrirë në të gjitha televizionet kombëtare si dhe një pjesë e televizioneve lokale si më poshtë:

Top Channel

Tv Klan

Vizion +

TVSH

Report Tv

News 24

Ora News

A2 CNN

Abc News

Fax News

Scan TV

Plani mediatik duhet të përfshijë të paktën 160 herë transmetimi në të gjitha televizionet të mbledhura bashkarisht me një total kohe prej 4830 sekonda.

Oraret e transmetimit duhet të jenë midis frekuencës 7:00 deri në 23:00

B. KRITERET KUALIFIKUESE:

Dokumentacioni që duhet paraqitet nga ofertuesit me qëllim kualifikimi:

1. Ekstrakt i thjeshtë dhe historik i regjistrit i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.
2. Vertetim i lëshuar nga administrata tatimore ku vertetohet se subjekti ka plotësuar detyrimet fiskale, ka paguar të gjitha detyrimet e sigurimeve shoqërore, të lëshuar nga Administrata Tatimore.
3. Ofertën ku të jetë specifikuar oferta sipas zërave të shërbimit.
4. Shërbime të së njëjtës natyre të realizuara gjatë tre viteve të fundit (2016, 2017, 2018), për këtë të paraqitet kontrata ose fatura tatimore shitje për shërbime të realizuara me institucione publike ose private.
5. CV dhe kualifikime profesionale të stafit kryesor të shoqërisë.
6. Projekt ide të realizimit të paketës promovuese.

Kriteret e vlerësimit: Çmimi më ulët i ofertës së kualifikuar.